



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. 95 Prot.

Tiranë 17/08/2023

Lënda: Njoftim për mbledhjen e parë të Komisionit të Pavarur Ad Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatisë

Drejtuar: Z. Sandër Simoni
Kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

Gjykata e Lartë
Rruga "Ibrahim Rugova"
Tiranë

I nderuar z. Simoni!

Bazuar në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në vijim të publikimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, të shpalljes së vendeve vakante dhe thirrjes për paraqitjen e shprehjes së interesit për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatëve dhe nga shoqëria civile, Avokati i Popullit nisi menjëherë punën për ndjekjen dhe zbatimin e procedurave të nevojshme administrative për zhvillimin e procesit, në përputhje me kompetencat dhe afatet e përcaktuara në ligjore.

Në përputhje me nenet 23, 26 dhe 124 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, pas përfundimit të procedurave për ngritjen e Komisionit të Pavarur Ad Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatisë, Avokati i Popullit, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Pavarur Ad Hoc, thërret mbledhjen e parë të tij.

Sipas dispozitave të sipërcituara, Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është pjesë e Komisionit të Pavarur Ad Hoc në cilësinë e zëvendëskryetarit të këtij komisioni.

Sa më sipër, në përmbushje të detyrimeve ligjore, dëshirojmë tju bëjmë të ditur se mbledhja e parë e Komisionit të Pavarur Ad Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatisë, do të zhvillohet *ditën e enjte, datë 24.08.2023, ora 11.00*, pranë zyrave të Avokatit të Popullit.

Lutemi marrjen e masave të nevojshme për të qene të pranishëm ose në pamundesine tuaj, është e detyrueshme prezenca e anëtarit zëvendësues (Zëvendëskryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi).

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin, mbetemi në pritje të konfirmimit.

Me respekt,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Fatbardh Zenelaj

